



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.76/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Faton Ademi kryesues, Afijete Sada Glllogjani dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur lidhur me apelin e Albina Krasniqi-t nga Danimarka, të paraqitur kundër vendimit të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 22.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si i parregullt apeli Anr.76/2019, i datës 20.09.2019, i parashtruar nga Albina Krasniqi nga Danimarka, me të cilin ka kërkuar që të përfshihet në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 20.09.2019, PZAP-i ka pranuar një apel nga Albina Krasniqi, në të cilën parashtruesja e apelit pretendon se i është mohuar e drejta për të votuar pasi që nuk është përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës në lisat e shpallura nga KQZ, edhe pse sipas saj ajo ka dorëzuar dokumentet e nevojshme për aplikim siç janë letërnjoftimi dhe pasaporta e Kosovës.

Parashtruesja e apelit nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi të pretendimeve në apel.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi rregullsinë e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i parregullt

Paneli i PZAP-it, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apeli i parashtruar nga ana e Albina Krasniqi-t është i parregullt, dhe si i tillë apeli nuk i plotëson standardet e kërkuara sipas nenit 10 par.7 të Rregullës Nr.02/2015.

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e apelit, ngase nuk janë plotësuar kriteret e kërkuara ligjore nga dispozita e cekur më lart.

Nga arsyet e sipërshënuara e në mbështetje të nenit 5.7 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it (Nr.02/2015) dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.76/2019 më datë 22.09.2019

Kryesues i Panelit
Faton Ademi



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në *Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*